



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/05

Datë: 22.02.2010

Në bazë të **nenit 14** të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 14/80 dhe 42/86); **nenit 40** të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008); **nenit 10** shkronjat **b), c) dhe j)** dhe **nenit 20.1** shkronja **d)** e Statutit të Komunës së Junikut Nr. 001/696 të datës 27.11.2008, Kuvendi i Komunës së Junikut në Mbledhjen e rregullt të mbajtur më 22 shkurt 2010, merr:

V E N D I M

Për Caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

Neni 1

Miratohet **Vendimi** për Caktimin e Lokacionit për ndërtimin e **Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare** (në tekstin e mëtejme **QKMF**) për nevojat e qytetarëve të Komunës së Junikut.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e QKMF-së, sipas Nenit 1 të këtij **Vendimi** do të **Caktohet** në Ngastrën Kadastrale Nr. **2018** me sipërfaqe të përgjithshme 1147 m² e evidentuar në Certifikatën e Pronësisë P-70505038-02018-0 Pasuri Shoqërore dhe pjesërisht në Ngastrën Kadastrale Nr. **5075** me sipërfaqe të përgjithshme 254621 m² e evidentuar në Certifikatën e Pronësisë P-70505038-05075 Pasuri Shoqërore, Zona Kadastrale Junik.

Neni 3

Ky **Vendim** paraqet bazë për dhënien e Pëlqimit në Lokacion, dhënien e Lejes Urbanistike, Lejes së Ndërtimit dhe Lejes së Përdorimit të objektit për të cilin është caktuar Lokacioni sipas këtij **Vendimi**.

Neni 4

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Zyra e Kryetarit dhe Udhëheqësja e personelit në Komunën e Junikut.

5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit.

Me Vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për PUGJK dhe Mjedis,
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Sinan Gacaferi
